



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE JURIDIKE DHE INTEGRIMIT  
DREJTORIA E SHËRBIMEVE JURIDIKE  
SEKTORI I NDIHMËS DHE KOORDINIMIT TË INFORMACIONIT**

Nr. 951 Prot.

Tiranë, më 27 . 03 .2026

**NJOFTIM ME SHPALLJE**

**TË VENDIMIT NR. 501/1 PROT., DATË 12.03.2026 TË INSPEKTORIT TË  
LARTË TË DREJTËSISË, “PËR ARKIVIMIN PAS SHQYRTIMIT FILLESTAR  
TË ANKESAVE TË PARAQITURA NGA SHTETASI Z. NIKO MITRE”**

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesat e paraqitura nga z. Niko Mitre me nr. 2981 prot., datë 14.11.2024, nr. 2981/2 prot., datë 26.11.2024 dhe nr. 2981/4 prot., datë 03.12.2024, në të cilën ngrihen pretendime ndaj veprimtarisë së magjistratëve z. A.S., dhe G.Sh., me detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë dhe prokurorisë pranë kësaj gjykate, në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur dhe me vendimin nr. 501/1 prot., datë 12.03.2025, “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të paraqitura nga shtetasi z. Niko Mitre”, bazuar në nenin 121, pika 2, shkronja “a” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e tyre. Vendimi duhet t’i njoftohet ankuesve, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesit mund të paraqesin ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e deklaruar nga ankuesit, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Tiranë, sipas adresës së lënë nga ankuesi: Bulevardi “Gjergj Fishta”, pallati 1, apartamenti 15, Tiranë;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: [www.ild.al](http://www.ild.al)

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

**Dëshira Pasko**

